

# Përdorimi i TIK-ut në familje dhe nga individë (isoc\_i)

Metadeta e referencës në strukturën e metadatës së SDMX Euro

(ESMS)

INSTAT

## Metadeta referenciale

1. Kontaktoni.....	2
2. Përditësimi i metadatës .....	2
3. Paraqitja statistikore .....	2
4. Njësia matëse.....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional .....	4
7. Konfidencialiteti .....	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes .....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	6
11. Menaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria .....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	9
15. Koherenca dhe krahasueshmëria .....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	10
17. Rishikimi i të dhënave .....	10
18. Përpunimi statistikor.....	11
19. Komente.....	12
Aneks.....	12

<b>1. Kontaktoni</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjes, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Eriona Dhamo
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjes
1.5. Adresa postare	Rr: “Vllazën Huta”, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi ZIP 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:edhamo@instat.gov.al">edhamo@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+ 355 (4) 2 2233357/249
1.8. Numri i faksit	+ (355) 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatës</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	29.12.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	29.12.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	29.12.2023
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Të dhënat për këtë fushë mblidhen çdo vit nga INSTAT dhe bazohen në pyetësorët model vjetor të Eurostat për përdorimin e TIK (Teknologjitë e informacionit dhe Komunikimit) në familje dhe nga individë. Pyetësi model ndryshon çdo vit. Ndryshimet e pyetjeve në PM (pyetësin model) kërkohen nga situata evoluese e teknologjive të informacionit dhe komunikimit.</p> <p>Qëllimi i vrojtimit evropian për TIK është sigurimi në kohë i statistikave për individët dhe familjet për përdorimin e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit në nivelin Evropian. Të dhënat për këtë aktivitet statistikor sigurohen direkt nga vrojtimet pa trajtim të veçantë.</p> <p>Të dhënat të cilat mblidhen mundësojnë prodhimin e statistikave sipas seksioneve të</p>

	<p>mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hyrja dhe përdorimi i TIK-ve nga individë dhe / ose në familje;</li> <li>• Përdorimi i Internetit dhe rrjeteve të tjera elektronike për qëllime të ndryshme nga individë dhe / ose në familje;</li> <li>• Siguria dhe besimi i TIK-ut;</li> <li>• Kompetenca dhe aftësitë e TIK-ut;</li> <li>• Pengesat për përdorimin e TIK-ut dhe internetit;</li> <li>• Efektet e perceptuara të përdorimit të TIK-ut tek individët dhe / ose familjet;</li> <li>• Përdorimi i TIK-ut nga individët për të shkëmbyer informacione dhe shërbime me qeveritë dhe administratat publike (e-qeveria);</li> <li>• Hyrja dhe përdorimi i teknologjive që mundësojnë lidhje me internetin ose rrjetet e tjera nga kudo në çdo kohë (lidhje e gjithëpranishme).</li> </ul>
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p><a href="#">ISCO 08, ISCED 2011</a></p> <p>TIK në familje mbledh informacione edhe mbi karakteristikat socio-demografike. Klasifikimet Ndërkombëtare të përdorura në këtë studim janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lista Kombëtare e Profesioneve (e miratuar sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Profesioneve - ISCO 08).</li> <li>2. Sistemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit (ISCED 2011).</li> </ol>
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Vrojtimi është një studim i përgjithshëm i popullsisë / familjeve.</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Vrojtimi pranë familjeve përfshin pyetje në nivel familje dhe individ. Të dhënat në nivel familje dhe individuale janë të ndara siç përshkruhet në pikën 3.1. Eurostat siguron një pyetsor model për përdorimin e TIK-ut në familje / nga individët i cili mbulon fushat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aksesitë në teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (të dhënat e mbledhura në nivel familje);</li> <li>• Përdorimi i Internetit (të dhënat e mbledhura në nivel individual);</li> <li>• Përdorimi i kompjuterëve, vendndodhja, shpeshtësia e përdorimit, aktivitetet (të dhënat e mbledhura në nivel individual);</li> <li>• Përdorimi i e-Qeverisë (të dhënat e mbledhura në nivel individual);</li> <li>• Përdorimi i e-Blerjeve (të dhënat e mbledhura në nivel individual);</li> <li>• Aftësitë teknologjike/kompjuterike;</li> <li>• Siguria në internet;</li> <li>• Karakteristikat socio-demografike.</li> </ul> <p>Përkufizimet:</p> <p><b>Një njësi ekonomike familjare (NjEF)</b> i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.</p> <p><b>Periudha e referencës/referuese</b> është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e</p>

	<p>caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.</p> <p><b>Interneti</b> është sistemi rrjeteve kompjuterike të ndërlidhura që përdor Suitën e Protokollit të Internetit (TCP/IP) për të lidhur miliarda pajisje në të gjithë botën. Ai është një rrjet i rrjeteve që përbëhet nga miliona rrjete private, publike, akademike, biznese dhe qeveritare, me fushëveprim lokal deri në global, të lidhura nga një koleksion i gjerë elektronik, wireless dhe teknologjitë e rrjeteve optike. Interneti mbart një gamë të gjerë të burimeve të informacionit dhe shërbimeve, të tilla si dokumentet e ndërlidhura hypertext dhe aplikacionet e World Wide Web (WWW), posta elektronike, telefonia dhe rrjetet peer-to-peer për file sharing.</p> <p><b>Akses</b> i referohet qasjes në internet jo vetëm në shtëpi por edhe nëse anëtarët e familjes mund t'a aksesojnë atë kur / ku të duan.</p> <p><b>Shërbimi me Internet Broadband</b> është forma më e përdorur e qasjes në internet për shkak të shpejtësisë së lartë; ajo ofrohet në disa forma të ndryshme, DSL, ADSL gjithashtu fibra optike, kabllor dhe satelit, rrjete WiFi publike, përmes antenës.</p> <p>Për detaje në të gjitha përkufizimet shihni <a href="#">Manuali metodologjik</a>.</p>
3.5. Njësia statistikore	Familjet dhe individët.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore janë të gjitha NjEF me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri. Kampioni i vrojtimit mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë.
3.7. Zona e referencës	Anketa mbi përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë. Banesat kolektive, shtëpitë për të moshuarit, spitalet, shtëpitë e rehabilitimit, duke përfshirë spitalet për fëmijë, shkollat me konvikte, hotelet, sanaturimet, institucione korrektuese dhe penale nuk janë të përfshira në vrojtimit.
3.8. Mbulimi në kohë	Anketa mbi përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët ka një shtrirje kohore 2 mujore çdo vit. Mbledhja e të dhënave ka filluar në vitin 2018 e në vazhdim.
3.9.Periudha bazë	Nuk aplikohet.
<b>4. Njësia matëse</b>	Përqindja përdoret si njësi e matjes për treguesit kryesorë të publikimit.
<b>5. Periudha e referencës</b>	Periodiciteti është vjetor, të dhënat mblidhen dhe përpilohen një herë në vit. Ky raport i përket vitit referencë 2023.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore mbi të cilën bazohet studimi vjetor i TIK-ut në familje konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17 / 2018, "Për Statistikat Zyrtare"</a></li> <li>• <a href="#">Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2022-2026</a></li> </ul>

	<p>Rezultatet e vrojtimit mbi përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët, në mënyrë që të krahasohen me vendet Evropiane, prodhohen duke zbatuar rregulloret e reja të Komisionit Evropian (KE):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">REGULATION (EU) 2019/1700</a> të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Statistikat e Komunitetit për Shoqërinë e Informacionit.</li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat mbi përdorimin e TIK në Familje dhe Individët transmetohen në EUROSTAT.
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura vlerësohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe kërkime shkencore, në përputhje me Ligjin Kombëtar të Statistikave Nr 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", datë 10.3.2018, dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Mbrotjtja e të dhënave personale". Neni 31 i Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" përcakton qartë se të gjitha informacionet statistikore të mbledhura nga INSTAT janë konfidenciale dhe mund të përdoren vetëm ose të publikohen në tabela të tilla përmbledhëse që nuk identifikojnë informacionin e njësisë. Identifikimi i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt me emrin, adresën ose ndonjë numër identifikimi të njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>Instituti Shqiptar i Statistikave mbron dhe nuk shpërndan të dhëna që ka marrë ose ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin direkt ose indirekt të njësive statistikore. Instituti i Statistikave në Shqipëri merr të gjitha masat e duhura parandaluese në mënyrë që të bëjë të pamundur identifikimin e njësive individuale statistikore me mjete teknike ose mjete të tjera që mund të përdoren në mënyrë të arsyeshme nga një palë e tretë. Të dhënat statistikore që mund të mundësojnë identifikimin e njësive statistikore shpërndahen nga Instituti i Statistikave në Shqipëri nëse dhe vetëm nëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Këto të dhëna janë trajtuar, siç përcaktohet në mënyrë specifike në Rregulloret, në atë mënyrë që shpërndarja e tyre të mos çënojë konfidencialitetin statistikor ose</li> <li>Njësia statistikore ka dhënë pëlqimin e saj, pa asnjë rezervë, për zbulimin e të dhënave.</li> </ol> <p>Të dhënat konfidenciale që i transmetohen Institutit të Statistikave në Shqipëri përdoren ekskluzivisht për qëllime statistikore dhe të vetmit persona që kanë të drejtë të kenë akses në këto të dhëna janë personeli i angazhuar në këtë detyrë. Çështjet që i referohen respektimit të konfidencialitetit statistikor shqyrtohen nga stafi që punon në Institutin e Statistikave në Shqipëri. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë: në cilin nivel të detajuar mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejt ose indirekt, i njësive statistikore të anketuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë</p>

	përdoruesve; dhënia e hyrjes për studiuesit për të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet për shpërndarjen e statistikave publikohen në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftimet dhe vonesat janë para-shpallur në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendarin e Publikimeve</a> është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesin e përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë një të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të mediave. INSTAT dhe agjensitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet e mëposhtme të shpërndarjes përdoren për të nxjerrë rezultatet e Përdorimit të TIK-ut në familje dhe nga individë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <a href="#">Njoftimi për shtyp</a>;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. <a href="#">Të dhënat në formë tabele</a>;</li> <li>4. Pjesa e <a href="#">Informacionit e dedikuar</a> për të kontaktuar INSTAT.</li> </ol>
<b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>	Rezultatet e anketës mbi Përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët publikohen çdo vit.
<b>10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacione mbi treguesit kryesorë të siguar nga vrojtimi. Formatin e njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos dhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp të përdorimit të TIK-ut në familje dhe nga individë publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet e përdorimit të TIK-ut në familje dhe nga individë janë botuar në faqen e internetit të INSTAT: <a href="#">Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje, 2023</a>
10.3. Baza e të dhënave online	Të gjitha informacionet janë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze. Të dhënat për përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individë nuk gjenden në bazën e të dhënave statistikore, por të dhënat e hollësishme mund të gjenden në formatin Excel. Këto tabela mund të gjenden në lidhjen e mëposhtme: <a href="#">Shifrat Statistikore</a> .

10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Baza e të dhënave në nivel mikro nuk publikohet për arsye konfidencialiteti. Të dhënat e grumbulluara janë lloji i vetëm i të dhënave që u jepet përdoruesve të jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk janë publikuar, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të paraqesin kërkesa specifike për të dhënat e vrojtimit mbi "Përdorimi i TIK-ut në familje dhe nga individë" përmes një pjese të veçantë: <a href="#">Kërkesë të dhënash</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër në lidhje me përkufizimet e koncepteve kryesore dhe shpjegimeve metodologjike u jepet përdoruesve në fund të njoftimeve për shtyp dhe publikimeve. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme ose kur kërkohet. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve dokumenton të gjithë procesin dhe procedurën e punës për përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët për qëllime të brendshme.
<b>11. Menaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është e angazhuar të sigurojë cilësinë më të lartë në lidhje me përpilimin e informacionit statistikor. Në përputhje me Ligjin e Statistikave, INSTAT përdor metoda statistikore dhe procese në përputhje me parimet shkencore dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht, bëjnë analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe të sigurojnë që statistikave janë më të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, ai ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë nga Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane. INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve, orientimi i përdoruesit, orientimi i punonjësve, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e anketës së përdorimit të TIK-ut në Familje dhe nga Individët të krahasohen me të dhënat e vitit të kaluar për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e anketës së përdorimit të TIK-ut në Familje dhe nga Individët klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm. <ol style="list-style-type: none"> <li>Përdoruesit e jashtëm janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Institucionet e administratës publike;</li> </ul> </li> </ol>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Universitetet;</li> <li>• OJF kombëtare dhe ndërkombëtare;</li> <li>• Firma private;</li> <li>• Studiues, studentë dhe grupe të tjera të ngjashme.</li> </ul> <p>2. Me përdoruesit e brendshëm, nënkupton sektorë të tjerë brenda INSTAT që përdorin të dhënat e anketës si input në punën e tyre.</p> <p>Publikimet e rezultateve të përdorimit të TIK-ut në Familje dhe nga Individët dërgohen çdo vit tek një grup specifik i përdoruesve. Disa tregues kryesorë dërgohen duke plotësuar pyetësorë të ndryshëm në Komisionin Evropian, Eurostat, International Telecommunication Union (ITU).</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me TIK-un në Familje dhe nga Individët për vitin 2022 janë rreth 2.851 klikime.</p> <p>Gjatë vitit 2022, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e temës "Teknologjia e informacionit dhe Komunikimit" u vlerësua 3.65 (73 %) në një shkallë 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketa e Kënaqësisë së Përdoruesit</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave të TIK-ut në Familje dhe nga Individët gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar nga INSTAT me ato të rregulloreve të ndjekura. Përdorimet e TIK-ut në familje dhe statistikat e individëve, në mënyrë që të jenë të krahasueshme me ato të vendeve evropiane, prodhohen duke zbatuar rregulloren e re të Komisionit Evropian (KE) "Nr.808 / 2004" të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Komunitetin Statistikat mbi shoqërinë e informacionit.</p> <p>Shkalla e plotshmërisë të të dhënave për anketën mbi përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët për vitin 2023 është 100%. Kjo llogaritje bazohet duke marrë parasysh raportin e kërkesave të përmbushura nga INSTAT me atë që kërkohet nga rregulloret evropiane.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat kontrollohen me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Kur ndodhin ndryshime, të dhënat e anketës kontrollohen me burime alternative, nëse ka. Kur nuk ka informacion nga burime alternative, INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke telefonuar personat që i janë përgjigjur anketës. Masat e marra nga INSTAT çdo vit, për të rritur shkallët e përgjigjes ose për të zvogëluar ndikimin e mos përgjigjeve duke i imputuar ato janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dhënat grumbullohen direkt në familjet dhe individët;</li> </ul>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Anketa e përdorimit të TIK në Familje dhe nga Individë 2023 u krye nga INSTAT përgjatë dy muajve të vitit, me një kampion prej 7.200 NjEF. Në përfundim të</p>



	<p>vrojtimet ishin intervistuar rreth 4.864 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë.</p> <p>Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 67,6%.</p> <p>Gabimi për shkak të marrjes së mostrës së probabilitetit vlerësohet për tregues më të rëndësishëm, të cilat mund t'i gjeni në Tabelën A1 në Aneks. Të gjitha vlerat e treguesve peshohen për të qenë përfaqësuese për të gjithë popullsinë.</p>								
<p>13.3. Gabim jo i kampionimit</p>	<p>Mos-përgjigja në nivel njësie merr në konsideratë familjet që nuk janë në gjendje ose të gatshme për t'u përgjigjur, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje të gjejnë familjen, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të mos kryer intervistën.</p> <p>Niveli i mos-përgjigjes së njësive për “Përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët për vitin 2023” është 32.4%.</p> <p>Shkalla e mos-përgjigjes në nivel variabli për “Përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët për vitin 2023” është 0%. Zakonisht, kur familjet pranojnë t'i përgjigjen anketës, ata përgjigjen në të gjitha pyetjet e anketës.</p> <p>Mbi-mbulimi tregon përqindjen e familjeve që nuk duhet të jenë pjesë e vërtetimit, pasi ato janë jashtë fushës së studimit. Shkalla e mbi-mbulimit për “Përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët për vitin 2023” është 5.4%.</p>								
<p><b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b></p>									
<p>14.1. Afatet kohore</p>	<p>Rezultatet e përdorimit të TIK-ut në familje dhe nga individë janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 162 ditë pas përfundimit të grumbullimit të të dhënave (T+162). Periudha referuese e rezultateve të TIK 2023 është 03 Korrik 2023.</p> <table border="1" data-bbox="461 1276 964 1407"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>07/03/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>12/12/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>162</td> </tr> </table>	Periudha referuese	07/03/2023	Data e publikimit	12/12/2023	Afatet kohore	162		
Periudha referuese	07/03/2023								
Data e publikimit	12/12/2023								
Afatet kohore	162								
<p>14.2. Përpikmëria</p>	<p>Të dhënat e Anketës së TIK shpërndahen sipas afatit të ri për publikim. Publikimi i përdorimit të TIK-ut në familje dhe nga individë ka qenë i përpiktë në kohë në 100% të publikimeve të kryera ndër vite.</p> <table border="1" data-bbox="461 1617 971 1759"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>07/03/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>12/12/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>12/12/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	07/03/2023	Data e shpallur	12/12/2023	Data e publikimit	12/12/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	07/03/2023								
Data e shpallur	12/12/2023								
Data e publikimit	12/12/2023								
Vonesa në kohë	0								
<p><b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b></p>									

<p>15.1. Krahasueshmëria - gjeografike</p>	<p>Të dhënat për përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët mblidhen sipas Rregullores (KE) Nr. 2019/1700 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Statistikat e Komunitetit për Shoqërinë e Informacionit, si dhe rregulloret vjetore të zbatimit që përcaktojnë variablat e monitoruara çdo vit.</p> <p>Meqënëse pyetësi i përdorur është i njëjtë siç kërkohet nga Rregulloret e EUROSTAT, statistikatat mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët mund të jenë të krahasueshme me ato të vendeve anëtare.</p> <p>Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivelin vendi.</p>
<p>15.2. Krahasueshmëria kohore</p>	<p>Të dhënat mbi përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët u prodhuan për herë të parë në 2018. Ato janë të krahasueshme ndër vite për pjesën më të madhe të indikatorëve, duke na siguruar një krahasueshmëri të mirë prej 6 vjetësh, CC2 = Jlast - Jfirst + 1 = 6).</p> <p>Krahasueshmëri të ulët vit pas viti për ato variabla/indikatorë që kanë ndryshuar si pasojë e ndryshimit të përkufizimeve dhe/ose pyetjeve në pyetësorë si pasojë e nevojës së matjes së zhvillimeve në TIK (p.sh internet nga telefoni, aftësitë).</p>
<p>15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave</p>	<p>Nuk aplikohet. Nuk ka asnjë studim apo burim të krahasueshëm administrativ që mund të merret si referencë për TIK-un në Familje dhe nga Individët. Vetëm të dhënat përfundimtare në përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët janë publikuar.</p>
<p>15.4. Koherenca e brendshme</p>	<p>Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohet. Lidhja midis variablave kontrollohet dhe koherenca ndërmjet serive të ndryshme të të dhënave kontrollohen para publikimit.</p>
<p><b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b></p>	<p>Personeli që punon për anketën e përdorimit të TIK-ut në Familje dhe nga Individët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Stafi i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 3 punonjës</li> <li>• Stafi në Zyrat Rajonale: 28 punonjës</li> <li>• Intervistuesit, Operator, Kontrollor (Staf i përkohshëm i INSTAT): 50 Intervistues.</li> </ul>
<p><b>17. Rishikimi i të dhënave</b></p>	
<p>17.1. Politika e rishikimit</p>	<p>Politika e rishikimit përdorimi i TIK-ut në Familje dhe nga Individët bëhet në përputhje me politikën e rishikimit të përgjithshëm dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantuar nga INSTAT i cili mund të gjendet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e Revizionimit Statistikor</a></li> <li>• <a href="#">Politika e Trajtimit të Gabimeve</a></li> </ul>

17.2. Praktika e rishikimit	Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi " përdorimin e TIK-ut në Familje dhe nga Individët" për vitin 2023, subjekt i këtij raporti.
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Në vitin 2023, Anketa mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët u krye me një kampion prej 7.200 NjEF. Në përfundim të vrojtimit u intervistuan rreth 4.864 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 67,6%.</p> <p>Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censit të homogjenizuara, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 10 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme.</p>
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen çdo vit.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat grumbullohen duke përdorur metodën CAPI me intervista ballë për ballë duke përdorur pyetësorë në laptop. Familjet ose individët duhet të identifikohen për t'u intervistuar, kampioni ndahet midis anketuesve; anketuesit përzgjidhen dhe trajnohen.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Për sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e redaktimit të të dhënave përgjithësisht i referohen nivelit mikro</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kontrolli sasior dhe cilësor i pyetësorit. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i pyetësorëve në hyrje, kontrollet e plotshmërisë, kontrolli logjik i pyetësorit. Numri i pyetësorëve që vijnë duhet të jetë i barabartë me numrin e pyetësorëve të shpërndarë në qarqe.</li> <li>• Kontrollet individuale bëhen për rastet e refuzimit dhe pa kontakte.</li> </ul> </li> <li>2. Korrigjimet aritmetike, korrigjimet logjike dhe verifikimi i koherencës midis përgjigjeve në pyetje të ndryshme të pyetësorit i cili kryhet me software-in SPSS.</li> </ol>
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Për përpilimin e rezultateve kemi tre procedura bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Analiza e cilësisë së të dhënave</b> Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli matematik i anketës;</li> <li>• Kontrolli logjik i të dhënave të anketës;</li> <li>• Krahasimi i të dhënave në seri kohore;</li> </ul> </li> </ol>

- Krahasimi i të dhënave me skedarë të tjerë që disponon INSTAT.

## 2. Trajtimi i mos-përgjigjeve

Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet:

- Pa kontakt;
- Refuzim i plotë;
- Refuzime të pjesshme (për variabla apo tregues të veçantë).

## 3. Një peshë e përshtatshme llogaritet për secilën njësi që raportoi të dhënat e saj.

Kjo peshë llogaritet për arsye të ndryshme: probabiliteti i pabarabartë i përzgjedhjes, rregullimi i mos përgjigjes, familjet që rezultojnë jashtë fushëveprimit, teknikat e kalibrimit.

18.6. Rregullimi

Nuk aplikohet.

## 19. Komente

### Aneks

Më poshtë jepen vlerësimet për përdorimin e Internetit deri në një vit më parë nga individët (16-74 vjeç) në Total vendi dhe sipas Gjinisë së bashku me devijimet standarde përkatëse.

**Tabela 1. Treguesit e saktësisë së përdorimit të Internetit deri në një vit më parë nga individët (16-74 vjeç) në nivel total vendi dhe sipas gjinisë.**

Nivel Total Vendi	Vlerësimi i Individëve	Devijimi Standart	Intervali i besimit 95%	
			I poshtëm	I sipërm
Individë (16-74 vjeç)	85.6%	0.7%	84.2%	86.9%
Burra	87.1%	0.8%	85.5%	88.5%
Gra	84.2%	0.8%	82.5%	85.8%